REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA ELBASAN**
**KESHILLI BASHKIAK**

Proces-verbal

A. Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e draft Planit Lokal te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2025-2030, dhe Rregullores perkatese, Bashkia Elbasan

Data e takimit: 17.04.2025

Vendi i takimit: Njesia Administrative Shushice, Bashkia Elbasan

Ora e hapjes së takimit: 14:00

Kryesues te takimit: Z. Lutfi Lala, Kryetar i Keshillit Bashkiak Elbasan, Z Asim Sula, NenKryetar i Bashkise Elbasan

Këshilltarë pjesëmarrës në takim, nr...1

emrat: Lutfi Lala (kryetari i këshillit Bashkiak)

Anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Sherbimet Publike, dhe Mjedisit

nr....... 1

Punonjës të administratës pjesëmarrës në takim, nr...6.

emrat: Asim Sula, Albert Hajrulla, Gëzim Ruda, Zerina Breshka, Taulant Shanaj, Lorena Haxhiymeri.

Anëtarë të strukturave komunitare pjesëmarrës në takimi, nr...1

emrat: Aziz Paja

Pjesëmarrës në takim nga komuniteti: nr...19

Nga te cilet vajza/gra: nr...4...

B. Zhvillimi i takimit. Prezantimi i draft PLMIMNU 2025-2030, dhe Rregullores perkatese, Bashkia Elbasan

Plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane 2025 - 2030.

Prezantimi i pyetjeve, çështjeve për të cilat kërkohet opinion i publikut, Kryetari/Anëtari i Komisionit të Përhershëm te Sherbimeve Publike, dhe Kom te Mjedisit,

Zj/Z Zerina Braska

Pyetje nga publiku:

Ado te shtohet sasia e koshave?

Përgjigje nga punonjësi i drejtorisë/ sektorit, Znj/Z Taulant Sinanaj

Tek rregullorja janë përcaktuar të gjitha. Po blihen mjete, kontenierë të tjerë dhe pas pak muajsh sheshi do të plotësohet me kazanë.

Përgjigje nga Anëtaret e Komisionit të Përhershëm te Sherbimeve Publike dhe Kom te Mjedisit Plani që kemi hartuar përmban shtimin e koshave të ndarë si dhe shtimin e makinave të mbetjeve.

Folësi 1(emri, mbiemri) Seit Beqiri, ora

Komente/Rekomandime

Sasia e koshave është shumë e vogël. Duhet të shtohen dhe të vendosen në çdo vend.

Folësi 2 (emri, mbiemri, organizata) Rexhi Rakipi (OGP), ora

Komente/Rekomandime 1- Në vendbanimet tona të bëhet vlerësimi i nevojave bazuar tek nevoja për kosha 2- Ndërgjegjësim të ndarjeve të mbetjeve në burim. 3- Indentifikimi i ricikluesve rom dhe egjiptian dhe punsimi i tyre 4- Për familjarët t'u mundësohen disa pikë me të cilat mund të blejnë në supermarket 5- Bizneset do përfitojnë fond nga Bashkia për produktet që do u japin individëve familjar.

Folësi Gëzim Rudo (Administratori i njësisë), ora

Komente/Rekomandime

Duhet rritja e numrit të kazanëve jo vetëm në njësinë tonë por edhe në njësi të e tjera. Numri që është aktualisht i kazanëve nuk është i mjaftueshëm. Sidomos tek bizneset sepse ata kanë më shumë mbetje. Makinat duhet të vijnë rregullisht.

Folësi Aziz Paja (kryeplaku i fshatit), ora

Komente/Rekomandime

A do të shtohet ndonjë punëtor për të pastruar?

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

Folësi Plarent Tola, ora...........

Komente/Rekomandime...........

Në lagjet lart tek varrezat nuk pastrohen sepse nuk hyn makina.

Folësi Taulant Sinanaj (Dr), ora...........

Komente/Rekomandime...........

Deri dje në ato lagje i janë marrë mbetjet dorë me dorë dhe pastaj me kontenierë. Në planin që është bërë do shtohen kontenierë në solo lagje dhe koshe gjithashtu.

Folësi Lutfi Lala (Kryetar KB), ora...........

Komente/Rekomandime...........

Kur makina kalon gjatë rrugës diten e caktuar për mbledhjen e mbetjeve duhet që familjarët ti nxjerrin tek dera.

Folësi..........................................., ora...........

Komente/Rekomandime...........

Folësi..........................................., ora...........

Komente/Rekomandime...........

C. Konkluzionet e takimit, Kryetari i Keshillit Bashkiak, Z Lutfi Lala, Z Asim Sula, NenKryetar i Bashkise Elbasan

Aspekti i parë është të mbajmë qytetin, fshatin, ambientin tonë më të pastër, ku gjithsecili duhet të kontribojë për këtë. Aspekti i dytë është të menaxhojmë mbetjet urbane me kostot më të ulta. Dhe e treta në gjithë territorin të mbulojmë me menaxhimin e mbetjeve urbane, të mos ketë asnjë fshat, territor pa kosha. Do të shtojmë kosha që do të ndahen sipas kategorive, ku një pjesë do të riciklohen duke sjellë të ardhura.

D. Mbyllja e takimit. ora 15:00

Sekretari Keshillit Bashkiak

Sokol Sinani